

Cila është kompania që ka numrin më të madh të vonesave?

Nga të dhënat e administruara nga Autoriteti i Aviacionit Civil për vitin 2023, operatori ajror me fluksin më të madh të fluturimeve nga/drejt Shqipërisë është Ëizz Air, i cili zë rreth 59 % të tregut. Duke qenë se, operon kryesisht në tregun e bashkimit evropian, në të cilin Eurocontrol ka konstatuar se shkak kryesor i vonesave ndodh për arsye të vonesave nga një fluturim i mëparshëm (efekti domino- një situatë në të cilën një ngjarje shkakton një ngjarje tjetër të ngjashme, e cila nga ana tjetër shkakton një ngjarje të mëtejshme), ky efekt ka dhënë pasoja në numrin më të lartë të vonesave tek ky operator, e vlerësuar kjo natyrisht me 7928 fluturime të kryera nga kjo kompani për vitin 2023.

Cila është kompania që ka numrin më të madh të anulimit të fluturimeve?

Anullimet e kryera nga Ëiz Air EU kanë qënë në total 34 për vitin 2023, nga të cilat 25 kanë ndodhur për arsye të jashtëzakonshme (greva, kohë e keqe, difekte teknike, renie zjarri në aeroporte etj). Duke qenë se, shumica e anulimeve janë kryer për arsye të rrethanave të jashtëzakonshme, baza rregullatore për të drejtat e pasagjerëve nuk parashikon kompensim për këto situata.

Sa pasagjerë kanë qënë të afektuar nga këto anulime dhe vonesa të gjata dhe sa prej tyre janë asistuar apo kompensuar?

Në lidhje me këtë pyetje ju sqarojmë se, Autoriteti i Aviacionit Civil në zbatim të Urdhrit nr.1, datë 26.02.2013 “Për kompensimin dhe asistencën e pasagjerëve në rastin e mospranimit në bord të avionit dhe anulimit ose vonesës gjatë fluturimeve”, Reg 261/2004 e KE, trajton në bashkëpunim të ngushtë me operatorët ajrorë vetëm ato ankesa që përcillen nga pasagjerët pranë AAC-së. Kështuqë referuar këtyre të dhenave, pranë AAC-së janë referuar 208 ankesa nga 7,279,693 pasagjerë që kanë udhëtuar drejt/nga Shqipëria përgjatë vitit 2023. Për të gjitha këto ankesa është dhënë asistencë dhe aktualisht janë trajtuar/ kompensuar 139 dhe 69 janë në proces. Nga ankesat që janë në proces, 30 prej tyre janë në fazën e kryerjes së transaksionit financiar nga kompanitë ajrore

Në raste vonesazh apo anulimesh, a kanë ndjekur kompanitë në fjalë të gjitha pikat që parashikon ligji kundrejt pasagjerëve? (Shembull: Ushqim dhe pije freskuese; akomodim në hotel; transporti ndërmjet aeroportit dhe vendit të akomodimit; e drejta e rimbursimit) Në rast se jo, cilat kompani nuk kanë qënë koherente me ligjin? Si është vepruar kundrejt tyre, çfarë masash janë marrë?

Autoriteti i Aviacionit Civil monitoron në mënyrë konsistente kompanitë ajrore për përmbushjen e detyrimeve ligjore të operatorëve ajrorë në rast të vonesave, anulimeve etj sipas përcaktimeve të Urdhrit nr.1, datë 26.02.2023 të sipërcituar. Nëpërmjet këtyre proceseve monitoruese është konstatuar se këta operatorë i ofrojnë pasagjerëve të drejtat e përkujdesjes si ushqim, pije, akomodim në hotel dhe kur përbën rast edhe kompensim. Për sa i përket kësaj të fundit, Autoriteti i Aviacionit Civil kur vlerëson se pasagjeri duhet të kompensohet nga

operatori ajror, komunikon dhe vlerëson rastin në bashkëpunim me këtë operator deri në realizim të kompensimit.

Pavarësisht ndërhyrjes me mbështetje nga ana e AAC-së, kur pasagjerët dhe operatorët ajrorë kanë mungesë dakortësie mbi terma të kontratës (biletës) së lidhur ndërmjet tyre, atëherë Autoritetit të Aviacionit Civil informon pasagjerin për mundësinë e ndjekjes së rastit të tij në instancat ligjore.